

Vendim nr. 8 datë 03.03.2022

(V-8/22)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Vitore Tusha, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Altin Binaj, Përparim Kalo, Sonila Bejtja, Elsa Toska, anëtarë, me sekretare Belma Lleshi, në datën 03.03.2022 mori në shqyrtim në seancë plenare, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 14 (B) 2021 të Regjistrimit Themeltar, që u përket:

KËRKUES: BARDHYL IBRA

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

**DREJTORIA VENDORE E POLICISË SË QARKUT
ELBASAN**

AVOKATURA E SHETIT, ZYRA VENDORE DURRËS

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes të së drejtës kushtetuese të aksesit dhe të sigurisë nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, Gjykata Administrative e Apelit, si dhe Gjykata e Lartë. Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2021-386, datë 18.03.2021 të Gjykatës së Lartë dhe kthimi i çështjes për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 32, 33, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2 dhe 142 pika, 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 27 i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi parashtrimet e kërkuarit Bardhyl Ibra, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e prapësimeve të subjekteve të interesuara, Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut Elbasan dhe Avokaturës së Shtetit, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Në datën 18.03.2016 kërkuesi Bardhyl Ibra ka paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, me palë të paditur Drejtorinë Vendore të Policisë së Qarkut Elbasan, me objekt: *“Konstatimi i kryerjes së veprimeve të paligjshme nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan, duke dërguar për publikim në televizione e media të ndryshme të vendit, të emrit të kërkuesit, të sendeve të sekuestruara, të cilat ndodhen në dosjen penale nr. 2476 të vitit 2014 në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, përveç që ishin të pavërteta, të kryera botërisht, në dëmin tim dhe të shoqatës që përfaqësoj, duke më cenuar shumë nderin, dinjitetin, reputacionin, shkaktuar strese dhe shqetësime të tjera shpirtërore të bëra nëpërmjet televizioneve disa herë radhazi* 2. Detyrimi i të paditurit për shpërbllim të dëmit jopasuror në vlerën monetare në sasinë 2.000.000 lekë për cenim të nderit, dinjitetit, stresit të shkaktuar, vuajtjes fizike e shpirtërore mua dhe familjes time për shkak të dërgimit të këtij publikimi, për më tepër i padrejtë.”.

2. Nga dosja gjyqësore e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës rezulton se kjo gjykatë në datën 21.03.2016 ka mbajtur procesverbal për veprimet përgatitore, ku në zbatim të nenit 25, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (ligji nr. 49/2012) ka konstatuar se padia nuk ishte me të meta nga pikëpamja formale. Po kështu, është vendosur njoftimi i të paditurit për padinë dhe aktet shoqëruese të saj, si dhe paraqitjen prej të paditurit, ndër të tjera, të prapësimeve me shkrim brenda 10 ditëve.

3. Seanca përgatitore është caktuar në datën 04.05.2016 dhe për këtë qëllim kërkuesi është njoftuar me letërthirrjen e datës 25.03.2016, e cila rezulton e pafirmosur nga ai dhe me shënimin “*larguar*”. Adresa e caktuar nga kërkuesi në kërkesëpadi ka qenë në qytetin e Elbasanit, ndërsa adresa e vendosur në letërthirrje është në qytetin e Gramshit. Edhe në zarin me anë të të cilit kërkuesi ka depozituar kërkesëpadinë në gjykatën e shkallës së parë, adresa e tij figuron në Elbasan.

4. Në seancën përgatitore të datës 04.05.2016 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës ka konstatuar se kërkuesi nuk ka paguar taksën gjyqësore, nuk ka përcaktuar qartë dhe

saktë adresën për njoftim, pasi fletëthirja rezulton “larguar”, nuk ka paraqitur aktet në formën e kërkuar nga ligji, e për rrjedhojë ka vlerësuar se padia është me të meta, si dhe nuk plotëson kushtet formale të paraqitjes së saj. Me vendimin nr. 82-2016-574, datë 04.05.2016, kjo gjykatë, në zbatim të nenit 39, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 49/2012, ka vendosur: *“Mospranimin e padisë, pasi nuk plotëson kushtet e nenit 154 të Kodit të Procedurës Civile. Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë. Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, duke filluar nga e nesërmja e marrjes dijeni. Për palët në mungesë ky afat fillon nga dita e komunikimit të vendimit.”*. Në fund të vendimit është shënuar se *“vendimi mori formë të prerë datë 30.05.2016”*. Në dëftesën e komunikimit të vendimit nr. 82-2016-574, datë 04.05.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, drejtuar kërkuarit, është vendosur adresa në qytetin e Gramshit, ndërkohë që në këtë dëftesë komunikimi figuron vula postare e qytetit të Librazhdit.

5. Në datën 26.04.2019 kërkuari ka paraqitur në Gjykatën Administrative të Apelit kërkesën me objekt: *“Konstatimi i shkeljes të së drejtës kushtetuese të moskomunikimit të vendimit nr. 82-2016-574, datë 04.05.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës edhe sot e kësaj dite, duke kaluar afatet ligjore, duke ndenjur dosja për afër tre vite në sirtaret e kësaj gjykate, duke i mohuar të drejtën e aksesit dhe të sigurisë juridike për t’iu drejtuar gjykatave më të larta të sistemit gjyqësor, si dhe në Gjykatën Kushtetuese e më tej. Kërkoj të merret informacion për procedurat e ndjekura nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, në bazë të nenit 399/4 të Kodit të Procedurës Civile. Detyrimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës për t’i komunikuar kërkuarit menjëherë kopjen e vendimit të mësipërm dhe ndonjë akt tjetër procedural.”*

6. Në po të njëjtën datë (26.04.2019) kërkuari ka paraqitur edhe një kërkesë ankimore drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit kundër vendimit nr. 82-2016-574, datë 04.05.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Kjo kërkesë ankimore ka pasur si objekt: *Konstatimin e kryerjes së veprimeve të paligjshme nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan, duke dërguar për publikim në televizione e media të ndryshme të vendit, të emrit të kërkuarit, të sendeve të sekuestruara, të cilat ndodhen në dosjen penale nr. 2476 të vitit 2014 në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, përveç që ishin të pavërteta, të kryera botërisht, në dëmin tim dhe të shoqatës që përfaqësoj, duke më cenuar shumë nderin, dinjitetin, reputacionin, shkaktuar stresse dhe shqetësime të tjera shpirtërore të bëra nëpërmjet televizioneve disa herë*

radhazi” 2. Detyrimin e të paditurit për shpërblim të dëmit jopasuror në vlerën monetare në sasinë 2.000.000 lek për cenim të nderit, dinjitetit, stresit të shkaktuar, vuajtjes fizike e shpirtërore mua dhe familjes time për shkak të dërgimit të këtij publikimi për më tepër i padrejtë.”.

7. Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur njoftimin e palëve për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes, me sqarimin se deri në 5 ditë para seancës palët kanë të drejtë të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim. Për këtë qëllim, në datën 15.05.2019, në bazë të nenit 49, pika 2, të ligjit nr. 49/2012, është bërë shpallja e seancës.

8. Gjykata Administrative e Apelit me vendimin nr. 134, datë 30.05.2019 ka vendosur: “Nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor dhe dërgimin e çështjes pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës (kancelarisë së kësaj gjykate) për të trajtuar kërkesën objekt gjykimi.”. Gjykata Administrative e Apelit ka arsyetuar si vijon: “Referuar parashikimeve të nenit 10 të ligjit nr. 49/2012 (...)2. Gjykata Administrative e Apelit shqyrton: a) ankimet kundër vendimeve të gjykatës administrative të shkallës së parë; b) në shkallë të parë, mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative, si dhe raste të tjera të parashikuara me ligj”. Ndërsa sipas nenit 9 të ligjit nr. 49/2012 “Gjykata në çdo fazë dhe shkallë të gjykimit, qoftë edhe kryesisht, kur konstaton se çështja nuk bën pjesë në juridiksionin gjyqësor, merr vendim për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit dhe dërgimin e akteve organit kompetent(...)”. Referuar dispozitave procedurale të lartë cituara, Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se kërkesa e kërkuetit duhet të nxirret jashtë juridiksionit gjyqësor dhe t’i dërgohet për trajtim për veprime administrative Kancelarisë, pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.”.

9. Në datën 24.10.2019 kërkueti ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, e cila me vendimin nr. 00–2021–386, datë 18.03.2021, ka vendosur: “Mospranimin e ankimit të veçantë ushtruar nga kërkueti, Bardhyl Ibra kundër vendimit nr. 134, datë 30.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit”. Në vendimin e saj Gjykata e Lartë ka arsyetuar si vijon: “Kolegji sjell në vëmendje se pala kërkuete, Bardhyl Ibraj ka paraqitur ankim të veçantë ndaj vendimit nr. 134, datë 30.05.2019 të Gjykatës Administrative të Apelit, me mjetin e cilësuar prej tij “Rekurs” drejtuar Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë. Në nenin 9, pika 2, fjalia e parë të ligjit nr. 49/2012, parashikohet se ndaj vendimit të gjykatës që ka nxjerrë çështjen jashtë juridiksionit

“mund të bëhet ankim i veçantë në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë...Kolegji thekson se, Gjykata Administrative e Apelit ka bërë një vlerësim dhe analizë të fakteve dhe me të drejtë ka disponuar me nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor, në zbatim të nenit 9 të Ligjit nr. 49/2012, duke ja dërguar organit kompetent, Kancelarit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, për ta trajtuar në rrugë administrative kërkesën në lidhje me komunikimin e vendimit gjyqësor nr. 82-2016-574, datë 04.05.2016 të po kësaj gjykate. Gjithashtu, me të drejtë Gjykata Administrative e Apelit ka konkluduar, duke mos e shqyrtuar në themel kërkesën e paraqitur nga Bardhyl Ibra, pasi nuk plotëson kushtet dhe kriteret e parashikuar nga neni 10, pika 2 i ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, pasi nuk ka qenë përpara shqyrtimit të një ankimit të ushtruar ndaj vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë dhe nuk ishte përpara një kërkesë padie për kundërshtimin e një akti nënligjore normativ. Mbështetur sa më sipër, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë konkludon se vendimi nr. 134, datë 30.05.2019 i Gjykatës Administrative të Apelit, me të cilin është nxjerrë jashtë juridiksionit gjyqësor çështja, duhet të lihet në fuqi.”.

10. Në datën 19.08.2021 kërkuesi i është drejtuar me shkresë Gjykatës së Lartë, e cila në datën 23.09.2021, me shkresën nr. 2815/1, e ka informuar atë se “sipas verifikimeve në librat manualë dhe elektronikë rezulton se që në datën 20.04.2021 ka qenë e mundur marrja e vendimit nga palët e interesuara, si dhe e publikuar në faqen tonë të internetit.”.

11. Kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata), me kërkesë sipas objektit të mësipërm, në datën 18.08.2021 (sipas shënimit të shërbimit postar).

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

12. **Kërkuesi** në mënyrë të përmbledhur ka pretenduar se i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në elementet e mëposhtme:

12.1. *E drejta e aksesit në gjykim*, pasi Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Gjykata Administrative e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk i kanë komunikuar kërkuesit vendimet e tyre. Gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit duhet të njoftonin kërkuesin me një sërë formash të parashikuara në Kodin e Procedurës Civile (KPC) dhe ligjin nr. 49/2012, si dhe me anë të shpalljes. Gjithashtu, Gjykata

e Lartë ka legjitimuar shkeljet e të dyja gjykatave më të ulëta. Po kështu, të tria gjykatat nuk kanë njoftuar kërkuesin për datën e gjykimit dhe përbërjen e trupit gjykues.

12.2. *Standardi i arsytimit të vendimit*, për arsye se në vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit, në kundërshtim me nenin 142 të Kushtetutës, nuk përputhen me njëra-tjetrën pjesët hyrëse, arsyetuese dhe dispozitivi i vendimit, si dhe nuk është njohur e drejta e ankimit ose e rekursit. Kjo gjykatë nuk ka shqyrtuar themelin e çështjes dhe nuk është shprehur për moskomunikimin e kopjes së vendimit nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Nxjerrja e çështjes jashtë juridiksionit, si dhe dërgimi për kompetencë kancelarit janë të pabazuara në ligj, pasi nuk është kompetencë e kancelarit të shqyrtojë çështje të tilla.

12.3. *E drejta për t'u dëgjuar* nga Gjykata e Lartë, pasi mungesa e njoftimeve të akteve nuk mund të sjellë mohimin e së drejtës për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për shkaqet e ngritura në ankim ose rekurs. Për rrjedhojë, ka pasur shkelje edhe të së drejtës së aksesit në Gjykatën e Lartë dhe të së drejtës për t'u mbrojtur.

12.4. *E drejta e gjykimit brenda afatit të arsyeshëm* për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga gjykatat e faktit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

13. Çështja e legjitimitimit është një ndër aspektet kryesore që lidhet me vënien në lëvizje të një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

14. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Kriteret për pranueshmërinë e kërkesës janë të natyrës kumulative, pra mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

16. Në çështjen konkrete, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

17. Një tjetër kriter paraprak, që duhet të përmbushet nga individi përpara se t'i drejtohet kësaj Gjykate, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike*. Sipas nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Gjykata vendos për gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve, pasi të jenë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese, që individi pretendon se i janë cenuar nga akti i pushtetit publik. Qëllimi i këtij neni të Kushtetutës është, ndër të tjera, të mundësojë, brenda sistemit gjyqësor të zakonshëm, parandalimin ose riparimin e shkeljeve të pretenduara, përpara se të tilla pretendime të paraqiten në Gjykatën Kushtetuese (*shih vendimet nr. 15, datë 07.05.2018; nr.54, datë 24.07.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Gjykata ka pohuar se mbrojtja kushtetuese ka një funksion *subsidiar* dhe ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme, që përmbyll procesin gjyqësor. Cenimi i së drejtës për një proces të rregullt ligjor, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelimeve dhe kjo vlen edhe në rastet kur procedurat gjyqësore paraprake çojnë në një rëndim të mëtjeshëm ose në tejzgjatjen e cenimit të kësaj të drejte (*shih vendimin nr. 29, datë 30.03.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në lidhje me sa më lart, kërkuesi në mënyrë të përmbledhur ka pretenduar cenimin e: (i) *së drejtës së aksesit në gjykim* për shkak të mosnjoftimit të vendimit nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë; (ii) *standardit të arsytimit të vendimit*, për arsye se Gjykata Administrative e Apelit nuk ka shqyrtuar themelin e çështjes, nuk është shprehur për moskomunikimin e kopjes së vendimit nga ana e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë

Durrës dhe nuk e ka bazuar në ligj dërgimin e çështjes për kompetencë kancelarit; (iii) *së drejtës për t'u dëgjuar* nga Gjykata e Lartë, pasi mungesa e njoftimeve të akteve i ka mohuar të drejtën për t'u dëgjuar dhe për të marrë përgjigje për shkaqet e ngritura në rekurs; (iv) *së drejtës së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm*, për shkak të mosshqyrtimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm nga gjykatat e faktit.

20. Në çështjen konkrete Gjykata vëren se kërkuesi i është drejtuar me kërkesëpadi Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, duke kërkuar *“konstatimin e kryerjes së veprimeve të paligjshme nga ana e Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan dhe shpërblimin e dëmit jopasuror.”*. Nga dosja gjyqësore rezulton se kërkuesi nuk ka marrë dijeni për seancën përgatitore të datës 04.05.2016 të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës, pasi adresa e vendosur në fletëthirrje ka të shënuar qytetin e Gramshit, ndërkohë që kërkuesi, sipas kërkesëpadisë, është banues në qytetin e Elbasanit. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Durrës, pasi ka konstatuar se padia ishte me të meta, me vendimin nr. 82-2016-574, datë 04.05.2016, ka vendosur mospranimin e saj. Sipas akteve të dosjes, edhe komunikimi i vendimit të kësaj gjykate për mospranimin e padisë i është dërguar kërkuesit në datën 04.05.2016 në qytetin e Gramshit dhe jo në Elbasan, ku ai është banues.

21. Kërkuesi, pasi ka marrë dijeni për vendimin gjyqësor të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës për mospranimin e kërkesëpadisë nuk rezulton të ketë bërë ankim ose kërkesë për rivendosje në afat të ankimit, por i është drejtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë Gjykatës Administrative të Apelit dhe më pas Gjykatës së Lartë me një kërkesë, ku kundërshtonte veprimet administrative të administratës gjyqësore për mungesën e njoftimit të tij.

22. Siç është përmendur më lart (*shih paragrafin 5*), kërkuesi, në datën 26.04.2019, i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit, duke kërkuar, ndër të tjera, konstatimin e shkeljes të së drejtës për t'u njoftuar për vendimin gjyqësor. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 134, datë 30.05.2019, ka vendosur nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit gjyqësor dhe dërgimin e saj për veprime administrative në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës (kancelarinë e kësaj gjykate) për të trajtuar kërkesën objekt gjykimi. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Lartë me vendimin nr. 00–2021–386, datë 18.03.2021.

23. Për sa më sipër, Gjykata vëren se thelbi i padisë së kërkuesit, konkretisht konstatimi i veprimeve të paligjshme të Drejtorisë së Policisë së Qarkut Elbasan dhe shpërblimi i dëmit jopasuror nuk është gjykuar në themel, pasi kërkesëpadija e tij nuk është pranuar për shkak të të

metave në paraqitjen e saj. Nga ana tjetër, kërkuesi, pasi ka marrë dëgjimin për vendimin e mospranimit të kërkesëpadisë, megjithëse kishte në dispozicion mjetin ligjor procedural të ankimit ose të kërkesës për rivendosje në afat të ankimit, ka zgjedhur një rrugë procedurale të ndryshme, duke iu drejtuar fillimisht gjykatës së apelit në mënyrë të drejtpërdrejtë me kërkesë për konstatimin e cenimit të së drejtës së njoftimit të vendimit dhe më pas Gjykatës së Lartë.

24. Bazuar në sa më lart, kërkuesi nuk ka arritur t'i provojë Gjykatës që ankimi individual kushtetues i paraqitur prej tij ishte mjeti i fundit efektiv për rivendosjen në vend të të drejtave të pretenduara si të cenuara dhe se nuk ekzistojnë më mjete dhe rrugë ligjore për mbrojtjen e këtyre të drejtave. Vendimet gjyqësore që ai ka kundërshtuar para Gjykatës nuk janë vendime përfundimtare, sipas kuptimit të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës. Për sa i përket themelit të çështjes, Gjykata vlerëson se kërkuesi nuk i ka ezauruar mjetet ligjore të disponueshme që parashikon legjislacioni procedural përkatës, dhe, për rrjedhojë nuk ka marrë përgjigje përfundimtare nga pikëpamja e kushtetutshmërisë për themelin e çështjes, që të mundësonte kontrollin kushtetues ndaj saj.

25. Në lidhje me pretendimin e kërkuesit për cenimin e së drejtës për t'u gjykuar brenda një afati të arsyeshëm, Gjykata vëren se ai nuk ka dhënë asnjë argument kushtetues konkret për këtë pretendim, duke mos specifikuar se për cilat shkallë gjykimi ka pretendime për tejzgjatje të procesit. Për pasojë, Gjykata çmon se ky pretendim nuk është ngritur në nivel kushtetues.

26. Si përfundim, bazuar në sa më sipër, Gjykata vlerëson se kërkesa e paraqitur prej kërkuesit duhet rrëzuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 131, pika 1, shkronja "f", të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, njëzëri,

V E N D O S I:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 03.03.2022

Shpallur më 04.04.2022